



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-004

Prishtinë, më 17 dhjetor 2014, në orën 16:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 17 DHJETOR 2014

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Uran Ismaili dhe Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryetari, në vazhdim procedoi me këtë:

Rend dite

1. Propozimi për formimin e komisioneve parlamentare, numri dhe struktura e tyre

Kryetari i njoftoi nënkryetarët e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare se propozimi i Kryesisë së Kuvendit për formimin e 14 komisioneve parlamentare, në mbledhjen plenare, të mbajtur më 15 dhjetor 2014, nuk i mori votat e nevojshme nga deputetët.

Ai theksoi se për formimin e komisioneve parlamentare të Legjislaturës V duhet të vendosim përsëri në Kryesinë e Kuvendit dhe se cilin propozim t'ia procedojmë Kuvendit për miratim.

Lidhur me propozimin për formimin e komisioneve parlamentare të Legjislaturës V, përkatësisht për emërtimin, numrin dhe strukturën diskutuan: Donika Kadaj-Bujupi, Ismet Beqiri Glauk, Konjufca, Adem Grabovci, Visar Ymeri dhe Myfera Shinik. Diskutimet e plota të tyre janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me pikën e lartpërmendur, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendit t'ia procedojë dy propozime për formimin e komisioneve parlamentare dhe atë:

- Propozimi për formimin e 14 komisioneve parlamentare - numri dhe struktura e tyre, sipas propozimit të Kryesisë së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 11 dhjetor 2014,

- Propozimi për formimin e 13 komisioneve parlamentare, sipas vendimit të Kuvendit, të datës 10 mars 2011.

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të enjten, më 18 dhjetor 2014, të mbajë seancën plenare, në orën 13:00, me këtë:

Rend dite:

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Të ndryshme:

Kryetarja e Grupit parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, e shtroi çështjen e emigrimit ilegal të qytetarëve të vendit tonë, të cilët janë duke e lëshuar vendin në masë të madhe për në vendet e Evropës. Ajo i propozoi Kryesisë së Kuvendit që ta radhisë në rend të ditës si pikë të veçantë për të debatuar lidhur për këtë çështje në njërin nga mbledhjet plenare të radhës.

Kryesia e mbështeti në parim propozimin e lartpërmendur, i cili do të radhitet në njërin nga seancat e radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 16:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale